



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS** **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

### **Procesverbal i mbajtur më 29 shkurt 2024, në mbledhjen e XXI-të (njëzetënjë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishme ishte edhe; Adelinë Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, dhe në pjesën e fundit të mbledhjes i bashkëngjitet edhe Leutrim Krasniqi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM

### **Rendi i ditës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin ndër të tjera theksoi, sa i përket materialit dhe thirrjes së mbledhjes besoj se të gjithë jeni pajisur me materialin siç dihet Grupi i Këshilltarëve të LDK-së, është pajisur me material edhe përmes CD-së sa i përket pikës parë për Zonën Industriale, lidhur me rendin e ditës nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim rendin e ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtarët e Komitetit sa i shinin prezent në sallë për momentin, njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

### **1. Procesverbalet nga mbledhjet e KPF-së të mbajtura më: 27 dhjetor 2023 dhe 29 janar 2024**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, kemi dy procesverbale nga mbledhjet e fundit të Komitetit për Politikë dhe Financa, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë i hedh në votim.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 9 vota Për, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohen procesverbalet sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje*

## **2. Propozim Vendimi për vënie në shqyrtim publik Draft Dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës kishte qenë më mirë të ishin të pranishëm Drejtori i urbanizmit ose Drejtori i financave, por nuk janë të pranishëm, dhe nuk kanë dhënë ndonjë arsyetim edhe pse kanë qenë të informuar, mirëpo nëse ndokush nga ju dëshiron të marr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, duke pasë parasysh pjesëmarrjen e Ekzekutivit, gjegjësisht nënçmimin që po ia bëjnë Kuvendit kur dihet se ne votuam në parim të gjitha pikat për të punuar me këtë rend të dite, unë mendoj ashtu siç mendojnë edhe kolegët tjerë, sepse kjo bëhet që t'i kalojnë shpejt pikat e rendit të ditës si rekomandim për Kuvend, pra kjo duhet të jetë temë e debatit sa i përket injorimit që i bëhet KPF-së dhe Kuvendit nga ana e Ekzekutivit.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, unë jam kundër që të rekomandohet kjo pikë e rendit ditës për seancën e radhës së Kuvendit për arsyeje se është shumë pikë e rëndësishme kurse ka neglizhencë nga ana e drejtorit të urbanizmit, e që edhe si proces është i neglizhuar sepse është dashtë të përfundoj vitin e kaluar, kështu që unë jam kundër që kjo pikë të kalojë në Kuvend për seancën e radhës.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, sa i përket drejtorit të urbanizmit z.Leutrim Krasniqi, ka qenë dje në zyrën time dhe më ka njoftua që është në një trajnim së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, dhe ka theksuar që ndokush nga ana e Ekzekutivit do të më zëvendëson në mbledhjen e KPF-së, këtu ka pasur mundësi të jetë prezent edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe ta prezantojë këtë pikë të rendit të ditës sepse këtu ka të bëjë edhe DBF por edhe drejtori në fjalë mungon, prandaj tani këtë pikë të rendit të ditës mund të hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

**z.Haki Rudari**, theksoi, natyrisht që ne e kemi marr rendin e ditës dhe kemi analizuar pikat e rendit të ditës. Grupi i LVV e përkrahim në parim që kjo pikë të kalojë për shqyrtim në seancën e radhës, mirëpo pajtohemi në parim që drejtorët e Drejtorive të Komunës duhet të jenë prezent, në rast se kanë arsye për mos ardhje atëherë duhet përmes Kryesuesit dhe formave të tjera të tregojnë arsyen për mos pjesëmarrje në seancë, sepse KPF është organ i lartë ku duhet të jenë prezent ata që i kanë sjell pikat e rendit të ditës por megjithatë ju e theksuat që drejtori është në një trajnim, mirëpo çdo drejtor i cili e sjell një pikë në rend të ditës duhet të jetë prezent në sall. Po e përsërisë, si Grup i LVV e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, edhe një herë më duhet të përsërisë, sa i përket drejtorit të DPUMM z.Leutrim Krasniqi, ai më ka informuar që nuk mund të jetë sot prezent në seancë për arsyet e cekura më lart, ndërsa për të tjerët nuk kam informacion se përse nuk janë në seancë.

Nëse nuk ka të interesuar të tjerë për të marr fjalën atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik draft dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 3 vota Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik draft dokumentin e planit rregullues të hollësishëm për Zonën Industriale.*

### **3. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Objekti afarist në ZK Orllan**

*- Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, pra në rend të ditës kemi 6 pika që ndërlidhen për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të Komunës, këto pika të rendit të ditës kanë qenë edhe në mbledhjen e kaluar por për shkak të mos pjesëmarrjes së Organizatave Joqeveritare që është dashtë të kenë një përfaqësues në komisionet përkatëse ka dështuar dhe nuk e di tani a ka aplikuar ndonjë OJQ në këtë rast.

Unë për çdo drejtor që nuk është serioz dhe mungon pa arsye do të votoj kundër sepse ne e dimë që mund të kemi ndonjëherë punë dhe raste apo obligime tjera, mirëpo unë prej tani e tutje do të votoj kundër për të gjitha pikat që drejtori përkatës nuk merr pjesë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, që në fillim e theksova se ky injorim që është duke i'u bërë Kuvendit të Komunës nga ana e Ekzekutivit gjegjësisht që sakt është duke u punuar në atë drejtim që Kuvendi është shndërruar në një makinë votuese për çka do që sjellët nga ana e Ekzekutivit. Nuk kam pas dëshirë që në këtë Kuvend dhe në KPF të diskutohet kjo çështje kur dihet se në një nga mbledhjet e kaluara e kemi pasur një dakordim për çka vendim nuk kemi marr sepse nuk kemi votuar, por kemi pasur ndërtim të një qëndrimi në fillimisht si anëtar të KPF, duke u nisur nga vet fakti që duhet të dimë në rend të parë se kë e përfaqësojmë ne dhe çka është ky Komitet, pra kemi pasur një dakordim që të mos votohet asgjë nëse nuk e kemi të pranishëm propozuesin dhe arsyetimin për pikën përkatëse të rendit të ditës, dakordim ai i cili nuk ka qenë i qëndrueshëm sepse në një formë i kemi hedh poshtë fjalët tona dhe e kemi praktikuar votimin e atyre pikave. Më vie mirë sot që nga kolegu z.Bashkim Sylja i cili në një formë e potencon atë që e kemi deklaruar që pikat e rendit të ditës mos të kalojnë nëse nuk kemi arsyetim, sepse fundja për çfarë pune është KPF, pra është një shkoqitje në detaje të gjithë propozimet dhe që t'i rekomandohet Kuvendit, por që është shndërruar në një makinë votuese, gjegjësisht jemi dal jashtë funksionit për çka ligjvënësi e ka paraparë këtë Komitet.

Duke u nisë nga kjo, ne vazhdimisht për propozim vendimet për dhënie në shfrytëzim, të gjithë e kemi dhënë pëlqimin si në foltore ashtu edhe në publik që asetet komunale duhet të jenë në funksion për shkak të zhvillimit ekonomik dhe mos t'i lëm asetet "të fjetura", e që asnjë Grup politik nuk ka kundërshtuar propozimet që pronat komunale të dalin në funksionin e tyre dhe se edhe Komuna të jetë në trend me vlerën aktuale të pronës komunale, por që në mbledhjen e kaluar kanë dështuar këto, jo që ka dështuar Kuvendi por ka dështuar procedura sepse ligji e parasheh që në kuadër të përbërjes së komisionit vlerësues të jetë edhe shoqëria civile, dhe gjasat janë që edhe sot po e përsërisë nuk e dimë se a ka aplikuar ndokush nga shoqëria civile, kurse ne jemi në situatë që duhet t'i rekomandohen Kuvendit këto pika, por që pastaj në Kuvend të na informoni që nuk kemi aplikues nga shoqëria civile, dhe sërish duhet të merret vendim që të anulohen, pra është një jo seriozitet në punën e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, në qoftë se ne i presim drejtorët e Drejtorive, atëherë ndoshta do të duhet që edhe Komitetin për Politikë dhe Financa tas mbyllim, mirëpo ne është mirë ta kryejmë punën tonë dhe drejtorët ta kryejnë punën e vet. Ne e dimë që kemi shoqëri civile, pra shumë Organizata që janë financuar nga Komuna që kanë drejtë të kenë një përfaqësues në Komisione përkatëse vlerësues e që qëllimi i kësaj është që të ndihmojnë Ekzekutivin për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe përmbushjen e obligimeve ligjore, sepse e dimë që pa pjesëmarrjen e tyre nuk mund të jenë funksionale ato komisione.

Pra ata (drejtorët e Drejtorive) nuk kanë shprehur gatishmëri të jenë këtu në mbledhje, të njoftuar janë të gjithë përmes emailit, përveç drejtorit të DPUMM që kam kontaktuar edhe fizikisht.

**z.Haki Rudari**, theksoi, anëtarët e KPF kanë të drejtën e shqyrtimit për pikat e rendit të ditës dhe ne jemi duke e bërë atë, kemi 12 pika të rendit të ditës për të cilat sponsoruese janë Ekzekutivi, unë vije nga Grupi i LVV partisë që është në pushtet, por secili prej Ekzekutivit, pa dallim, duhet të japin përgjegjësi për ardhje apo mos ardhje, e që këtu prezentë e kemi vetëm drejtoreshën e DSHMS, prandaj ajo çka i përket përgjegjësisë së Ekzekutivit po besoj që do të merret me këtë çështje edhe Kryetari i Komunës si dhe pas përfundimit të kësaj mbledhje do të shkojmë në takim të shikojmë arsyen përse nuk janë prezent.

Nëse janë mungesa të arsyeshme ata duhet ta informojnë Kryesuesin apo në forma të tjera, përndryshe kur vije këtu një rend i ditës e që unë në seancën e fundit e kam propozuar që të jetë edhe kalendari i mbledhjeve në mënyrë që të jenë mbledhje më serioze dhe ajo ka kaluar, çdo Drejtori e ka planin e punës për raportim, pastaj për mungesat e pikave në rend të punës natyrisht që përgjegjësin do të marr çdo njeri për vetën e vetë. Unë vij nga fusha e arsimit ku e kemi planin e punës dhe ai plan të punës duhet të shqyrtohet, të analizohet dhe duhet t'i përmbahemi sepse përmes planit të punës secili person e tregon seriozitetin e vet. Unë nuk e di përse neglizhohet që të sjellët informata shembull, por megjithatë e kemi të drejtën e rekomandimit, dhe këtë pikë të rendit të ditës e përkrahim që të kaloj në Kuvend për shqyrtim.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, problemi është që po dalim jo serioz, shembull në rastin konkret po të ishte drejtoresha e DPKGJ këtu do të na tregonte se a kanë aplikuar ndonjë nga shoqëria civile në mënyrë që mos të na ndodh si në seancën e kaluar, pra seanca e Kuvendit kur mbahet nuk është në rregull që të tërhiqen 5 ose 6 pika të rendit të ditës, kështu që nëse nuk kanë aplikuar përfaqësuesit e shoqërisë civile atëherë do të kishim mundësi që sot në këtë mbledhje të mos i rekomandojmë ato pika për në mbledhjen e Kuvendit, dhe nuk do të dalim jo serioz gjatë seancës së Kuvendit, përndryshe ne drejtoreshës së DPKGJ i kemi kërkuar edhe një raport vjetor për vitin 2023 me qëllim që të na informoj se cilat prona kanë qenë të dhëna në shfrytëzim nga komisionet e kaluar përkatëse, pra as ky raport nuk është sjellë këtu, kështu që unë mbetem në qëndrimet e mia. Pastaj kemi raste të kaluara kur drejtoresha në fjalë nuk ka ardhur por e ka lajmëruar për mungesën e saj dhe ne e kemi përkrahë atë pikë, mirëpo kjo siç po ndodh sot është jo serioze dhe unë nuk e përkrahi këtë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, më bëri përshtypje ajo që ti Kryesues e përmende më herët duke theksuar që a e mbyllim Komitetin për Politik dhe Financa, e dini që ne veprojmë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ne edhe me dashtë nuk mundemi ta zhbëjmë këtë Komitet. Ne jemi duke e treguar jo seriozitetin tonë për rolin që e kemi përcaktuar si politik bërje, vendimmarrje, planifikim dhe llogaridhënie, andaj ne mund që pa fajin tonë të kemi një Kuvend jo funksional dhe që pastaj si më e fundit mund të kërkohet që ne jemi duke e marr fajin e dikujt tjetër dhe jemi duke e bërë vetën jofunksional pa fajin tonë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, mendoj se duhet të bisedoj Kryetari me drejtor të Drejtorive që në mbledhjet e ardhshme të jenë prezent drejtorët, por sërish nuk jemi ne që po i'a kushtëzojmë këtë sepse po i'a kalojmë pikat në Kuvend, e që në mbledhjen e Kuvend besoj që do të vinë drejtorët e Drejtorive.

Pra ne jemi duke e kryer punën tonë por po del e zbehtë në aspektin që nuk po na japin informata për secilën pikë dhe ashtu siç e përmendi edhe z.Bashkim Sylja pastaj a kemi të interesuar nga shoqëria civile për formimin e komisioneve sepse për çdo pronë që miratohet të jepet në shfrytëzim duhet të formohet komision në përbërje prej 2 anëtar nga Kuvendi, 2 anëtar nga Ekzekutivi dhe 1 nga Shoqëria Civile, pra ligji shumë mirë i ka cekur kriteret por ne nuk i'u kemi përmbajtur, pra ju lus që sot ti kalojmë këto pika.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, për krejt nga kjo situatë që po na reflekton sot, unë mendoj që si KPF duhet të ndërtojmë një qëndrim, t'i bëjmë kërkesë Kryetarit të Komunës se çka është ka ndodh me Ekzekutivin i cili nuk dëshiron të jetë llogaridhënës para atyre që i ka zgjedhur qytetari e që mandati i tyre është që të kërkoj llogari. Nëse mendoni të gjithë që ne të ndërtojmë si qëndrim mund t'i drejtohem Kryetarit të Komunës se përse Ekzekutivi nuk i prezanton çështjet në KPF, më vie keq zonja drejtoresh (i drejtohet

znj.Adelinë Stublla), ti veç po dihet që je këtu, mirëpo ne nuk mund ti kërkojmë llogari drejtorit sepse fundja unë nuk e kam votuar drejtorin, por i kërkojmë llogari Kryetarit të Komunës.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, unë personalisht do të shkoj te Kryetari i Komunës pas këtij takimi dhe do të konsultohem me atë, se çka është puna e drejtorëve që mungojnë në mbledhjet e KPF-së, e që asnjëri prej neve nuk po pajtohem me këtë. Të gjithë kanë qenë të njoftuar për mbledhjen dhe për orarin, prandaj nuk dëshirojë që t'ju marr kohë më shumë as juve me këtë punë.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, edhe unë mënoj se pas kësaj mbledhje duhet të konsultohet Kryetari i Komunës rreth mungesës së drejtorëve të Drejtorive në mbledhje të KPF-së.

**z.Haki Rudari**, theksoi, as unë nuk pajtohem me këtë gjendje që është, dhe më herët e theksova dhe pas mbledhjes do të kontaktoj edhe me Kryetarin e Komunës për këtë problem.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, nëse nuk ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës që të rekomandohet për Kuvend.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 1 votë Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

#### **4. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - tetë (8) Lokale në Tregun e Qytetit, në njësinë kadastrale P-00244-1, ZK Podujevë**

*- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në Shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 1 votë Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

#### **5. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00495-4, ZK Lupç i Poshtëm** *- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me një pronë që pretendohet të jepet në shfrytëzim, andaj edhe për këtë urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 1 votë Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë**  
*- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në Shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 8 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 3 vota Për, 1 votë Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, ZK Turuçicë**  
*- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 1 votë Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**8. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, ZK Turuçicë**  
*- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 1 votë Kundër asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **9. Propozim Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës** **- Raporti nga diskutimi publik**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse ju kujtohet këtë Plan e kemi shqyrtuar edhe njëherë në Kuvend si draft fillestar dhe i cili ka marrë votat për të dalë në diskutim publik kështu që ndër të tjera është rregulluar / ndryshuar edhe shprehja .....“diskriminim”..... që ka qenë, pra është bërë .....“mos diskriminim”....., andaj urdhëroni nëse ka të interesuar për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse atëherë e hedhim në votim që t’i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **10. Propozim Vendimi për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore për Policët dhe Zjarrfikësit**

**znj. Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në koordinim me Kryetarin e Komunës dhe drejtorin e QKMF-së jemi dakorduar që të bëhet lirim nga participimi nga pagesa për shërbimet shëndetësore për pjesëtarët e policisë dhe zjarrfikësve, nëse e shihni të arsyeshme ju ftoj që të përkrahët dhe t’i rekomandohet në Kuvend.

**znj. Sebastina Vokrri**, theksoi, në si Grup i LVV e përkrahim këtë propozim vendim për lirim nga participimi nga pagesa e shërbimeve shëndetësore për policët dhe zjarrfikëset.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore për policët dhe zjarrfikësit, jemi për që të kalojmë si rekomandim në Kuvend, mirëpo nuk mendoj që është diçka që lehtëson punën qoftë stafit të policisë apo edhe zjarrfikësve.

Unë e di se çka është kujdesi primar shëndetësor dhe e dimë se çfarë trajtimesh mund të marrin në kujdesin primar shëndetësor si dhe e dimë se sa është pagesa e atyre shërbimeve, krejt kjo na dërgon te një pikë, e që më vonë e kemi për trajtim që ka të bëjë me mos diskriminim. Po ta shikosh Ligjin për barazi dhe mos diskriminim, a mund t’i themi vetit se ku janë pjesëtarët e FSK-së, punëtorët e arsimit e të tjerë e që në një formë jemi duke e bërë një dallim.

Policia e Kosovës kanë nevojë shumë për shtesën e rrezikshmërisë, e cila i është heqë, pastaj nuk e kanë sigurimin shëndetësor të jetës, mandaj shqyrtimin e mundësisë për lirim të parakohshëm të tyre, andaj unë mendoj që këto do të ishin ato që do të lehtësojnë dhe e ngritin nivelin e punës në Policinë e Kosovës dhe Zjarrfikësit, por kurrsesi nuk e mendoj që të lirohen nga participimi i tillë dhe në një formë t’i vëm në një kategori kur e dimë se cilat kategori janë të drejtuara dhe më duket një lojë që për mua shumë më kontributdhënëse do të ishte që Kuvendi nga kompetencat e veta që ka, të bëjë diçka për ndonjë radar statik që i’u ndihmon atyre në punë, të paktën jemi dëshmitar po e shihni se çka po na ndodh sidomos në pjesën e qytetit te stacioni i policisë.

Pra po kthehem prapa paksa, më duket që Kryesuesi i Kuvendit ka qenë më herët në një takim kur ka qenë e ndaluar edhe rruga andej, dhe kemi kërkuar që të lirohet dhe të trajtohet barabartë me qytetarët, dhe sot mund ta shihni që në anën e majtë të asaj rruge e kemi një parking ndërsa në anën e djathtë kemi vetura të parkuara në trotuar, dhe mendoj që më ndihmës për Policët do të ishte ky parking që është ndërtuar para

komunës dhe më e nevojshme do të ishte që atyre t'ju mundësohet parkingu, ashtu siç do të ishte edhe për stafin civil të Komunës, sepse për çdo ditë duhet të paguajnë nga 1 euro parkingun, kurse shërbimet shëndetësore për çka po diskutojmë dhe po pretendojmë ne që t'i lirojmë, është në atë çmim pra 1 euro, dhe nuk e mendoj që është një diçka që e bënë që Policia e Kosovës dhe Zjarrfikësit do ta ngritin nivelin e tyre, por përkundrazi qoftë në lehtësim të punës apo në barazi me shërbyesit apo zyrtarët publik që veprojnë brenda territorit të Komunës së Podujevës.

E potencova edhe në fillim se jemi për lehtësim, por nuk mendoj që ky lehtësim është i nevojshëm, pra nuk jemi kundër për këtë propozim, por në fillim e theksova që nuk mund ta pranojmë këtë gjendje se çka është duke ndodh me Kuvendin dhe organet e Kuvendit, mirëpo e përsërisë që drejtoresha e DSHMS është këtu dhe e paraqiti piken e propozuar nga ajo, por kemi pas raste kur nuk ka pas mundësi të jetë këtu por që në një formë e ka deleguar dikë tjetër dhe ne e kemi mirëkuptuar, mirëpo kjo formë që po ndodh sot na bënë që të mos marrim pjesë në votim as për, as kundër, as abstenim.

**znj. Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, ne e kemi parë të arsyeshme si mbështetje morale dhe jo diçka më shumë. Pajtohem plotësisht me ato që i theksove më herët (i drejtohet z.Naim Çunakut), por është diçka që nga DSHMS nuk mund të vëm radar statik, mirëpo kjo se çka mund të bëjmë është të paktën një mbështetje morale duke e marr si model nga disa Komuna tjera që faktikisht e kanë miratuar një vendim të tillë.

**z. Bashkim Sylja**, theksoi, e përkrahim këtë propozim vendim, mirëpo mendoj që qeverisja lokale më mirë do të ishte të ndaj një ndihmë tjetër për zjarrfikësit, përkatësisht që të rritet numri i tyre sepse ka qe 1 ose 2 vite që janë në mungesë të stafit, si dhe t'iu plotësohen kushtet tjera, kështu që kjo do të ishte ndihmë nga niveli lokal, ndërsa nga niveli qendror e dinë të gjithë se çfarë kërkesa kanë për paga të tyre dhe kategoritë tjera, e që thuajse paga e tyre është shumë e vogël, mirëpo drejtoresha e DSHMS e theksoj se sa i përket aspektit shëndetësorë, këtë mund të bëjë, andaj edhe jemi për këtë propozim vendim.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse atëherë e hedhim në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **11. Propozim Vendimi për caktimin e anëtarëve të komisioni të banueshmërisë**

**znj. Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, meqë kemi të bëjmë me mirëqenien sociale dhe pikërisht me çështjen e banimit social tek Lagjja e Dëshmorëve, sipas informatave që kemi aty ka persona që nuk i shfrytëzojnë ato shtëpi, kurse ne si DSHMS kemi kërkesa të shumta të qytetarëve që kanë nevojë për një strehë, atëherë e kemi parë të arsyeshme të caktohet një komision në përbërje prej të gjitha subjekteve politike dhe një anëtari të Shoqatave të dala nga lufta në mënyrë që të verifikohet kjo çështje pasi që kjo për ne është paksa bezdisëse pasi që shtëpitë po rrinë të mbyllura në atë Lagje, kurse kërkesat për strehim janë të shumta.

**znj. Sebastina Vokrri**, theksoi, edhe këtë pikë të rendit të ditës, ne si Grup i LVV-së e përkrahim propozim vendimin për caktimin e anëtarëve të komisioni të banueshmërisë.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, vërtetë ne jemi dëshmitarë të gjendjes e cila është e krijuar në Lagjen e Dëshmorëve, pa dashur të hyj në detaje rreth asaj se çka ka ndodh, por vërtetë pyetja që është dashur ne ta kemi për një sqarim për ato banesa që janë të ndërtruara prej Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për nevoja të një kategorie që kanë nevojë strehimin derisa nuk kemi zgjidhje tjetër, dhe të gjithë ata që



janë duke i shfrytëzuar ato banesa sigurisht që kanë një kontratë me ata që iu kanë dhënë banesat, do ishte mirë që ata nuk mund t'i përmbahen kontratave se fundja kontratat duhet të përmbushen, ndërsa ata që janë në kundërshtim me kontratën, t'i shkëputet kontrata, kurse kjo forma të cilën po e kuptoj se është për të tentuar gjegjësisht shmangien e parregullsive që mund të ketë dhe sigurisht që ka, ndoshta është një formë çfarë na është propozuar por duhet ta kuptojmë që diçka që rregullohet me ligj, nga ana kredenciale dhe ana morale i'u ik ngjyremeve politike, mirëpo nuk e di sa jemi në kohë me ligjin.

Një komision i ngritur nga Kuvendi në një formë ka qenë pjesë e ndarjes administrativisht, pastaj në një fazë të më vonshme, sërish po të drejtohem i nderuar Kryesues sepse e di që edhe ti ke qenë dëshmitarë, pastaj kur në një fazë të mëtutjeshme me sugjerim të Ministrisë është përjashtuar Kuvendi pasi që Kuvendi i Komunës ka marrë pjesë në ndarjen e banesave dhe tani po na vije një barrë që po kthehet sërish në Kuvend. Nuk e di bazën ligjore e nderuar drejtoreshë e DSHMS, a kemi të drejtë ta bëjmë këtë komision dhe a ka bazë ligjore, shembull kemi një situatë prej komisioneve që i formon Kuvendi pa dashtë të ngjyros apo të them që nuk ka diçka që nuk mund të rregullohet më mirë, mirëpo unë e di se komisionin e shëndetësisë e kemi të formuar në këtë Kuvend, ndoshta është dashur specifikisht është të merret me incizim të situatës dhe të raporton.

Vetëm një pyetje kam e nderuar drejtoreshë e DSHMS, çka nëse këta kanë bërë parregullsi, kush e lëshon vendimin që ata persona do të ikin prej atij vendi, fjala është për ata persona që në një formë janë keqpërdorues, do të thotë nuk janë duke i shfrytëzuar ato shtëpi për të cilat kanë marrë.

**znj. Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, ne e kemi parë të rrugës këtë formë, dhe atë pa ngjyreme politike ashtu qyshe e ceke edhe vet i nderuar zotëri Çunaku. Jemi në një situatë që nuk kemi të bëjmë me raste sociale në shumicën prej rasteve që janë banor në atë Lagje, dhe tani është bërë një kohë e gjatë që udhëheqë dhe t'ju them të drejtën i kam parë edhe vet se e lënë shtëpinë dhe kanë banesa tjera apo edhe raste që e përdorin disa, do të thotë ato shtëpi i përdorin vetëm për vikende, kurse pjesa tjetër që kemi rreth 20 kërkesave që vazhdimisht paraqiten në zyre për sigurimin e strehimit, kështu që unë këtë propozim vendim e kam sjellë në Kuvend që bashkërisht pa dallime politike ta diskutojmë dhe t'i shtjerrim të gjitha mundësitë e një të mire të mundshme.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk dua të keqkuptohem se qëllimin e mirë të kësaj po e shoh por e kuptoj por a e kemi gjetur modelin rrugën se si ta bëjmë më të mirën nuk jam i sigurt, çka nëse del diçka kundër këtij komisioni cilat janë kompetencat e tij se po formohet një komision dhe cilat janë kompetencat e tij a ka kompetencë ky komision ti japë kontratë diku që si ka dhënë kontratë krejt në kuptimin që të funksionoj mirë ky proces sepse nuk mund të ketë kompetenca ky komision për një gjendje reale dhe unë mendoj që pa përfshirjen e shoqërisë civile a ka pas vend formimin i një komisioni të tillë ta sheh gjendjen reale në terren se ka keqpërdorime dhe ne jemi kundër keqpërdorimeve kushdo që i ka bërë ato dhe është e pa ndershme dikush ta mbaj shtëpinë kur nuk e shfrytëzon askush dhe pjesa është në shfrytëzim të banimit social. Unë nuk di që kemi gjet rrugën më të mirë për ti zvogëluar mundësitë e keqpërdorimit në astet për të cilat i kanë marrë në shfrytëzim dhe nuk i shfrytëzojnë brenda rregullores, gjegjësisht kontratës që kanë marrë, kjo ishte ajo që kisha për të thënë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, unë mendoj se të gjithë e kemi qëllimin më të mirë se qysh të bëjmë zgjidhjen më të mirë, e që për të bërë një zgjidhje të mirë nuk është lehtë sepse është situatë shumë e ndjeshme, mirëpo unë mendoj se kjo çështje duhet të vij në Kuvend dhe të debatohet më gjatë, në Kuvend janë 35 këshilltar/e dhe ata mund të japin një mendim nëse veç vendosim të formojmë komision e që atij komisioni duhet të jene edhe kompetencat.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në mandatin 2013-2017 është formuar një komision prej Kuvendit në përbërje prej përfaqësuesve të 3 subjekteve, 1 përfaqësues nga Shoqatat e dala nga lufta dhe 1 përfaqësues nga DSHMS, komision i cili ka vendos dhe brenda atij intervali janë ndarë 50 objekte të banimit. Pastaj në vitin 2017 është formuar një komision që e ka udhëheq LDK-ja, por përbërja e komisionit ka qenë e partive tjera dhe tani jemi në një situatë tjetër ku kërkohet një komision prej partive të ndryshme.

Unë mendoj se në këtë komision së pari duhet të jetë 1 përfaqësues nga DSHMS-ja pasi që ai përfaqësues duhet të dërgoj materiale në komision dhe pastaj duhet shikuar Rregullorja, këtë po e them se atëherë ka qenë një Rregullore e cila specifikonte kontratën për shfrytëzuesit e atyre shtëpive, dhe të gjithë ata të cilët banojnë aty por kanë zgjidhje tjetër të banimit. Natyrisht se ata janë në kundërshtim me Rregulloren dhe nëse nuk gaboj diku shkruan se pala përfituese në momentin që siguron banimin, ai duhet ta liroj atë shtëpi. Në seancën e radhës duhet shikuar se a është në fuqi ajo Rregullore dhe a ka ndryshuar situata në mënyrë që ky komision pastaj të jetë i pavarur që të punoj.

**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, sa i përket punës së komisionit që u cek të jetë një përfaqësues nga DSHMS-ja, ne e përkrahim këtë propozim sepse kemi edhe zyrtaren përkatëse për strehim, andaj nëse e shihni të arsyeshme mund të jetë pjesë e komisionit, por problemi është që ne renditjen e anëtarëve të komisionit e kemi bërë në bazë të subjekteve politike dhe një anëtar nga Shoqatat e dala nga lufta, prandaj nëse ju e shihni të arsyeshme mund ta propozoni edhe një anëtar nga DSHMS.

**z.Haki Rudari**, theksoi, Shoqatat e luftës e kanë vendin e vet, nuk jam kundër renditjeve që janë bërë në bazë të partive politike që janë të përfaqësuara në Kuvend, por sido që të jetë ky komision duhet ta ketë një përfaqësues nga DSHMS i cili i furnizon anëtarët tjerë me lista dhe materiale tjera të nevojshme.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, sigurisht në këtë komision përveç përfaqësuesve të subjekteve politike do të jetë edhe një anëtar nga DSHMS, mirëpo për hapat e mëtejshëm drejtoresha e DSHMS do të na njoftoj, unë mendoj se problemi është te funksionimi i këtij komisioni.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, për mendimin tim problemi më i madh i këtij komisioni është baza ligjore dhe kompetencat e tij, nëse nuk ka bazë ligjore nuk e di cili është rezultati i atij vendimi dhe çfarë fuqie juridike ka ai vendim. Të gjithë ne jemi për zgjidhjen e problemit që aty mos të ketë keqpërdorime sepse është nivel i ulët dhe kemi të bëjmë me një kategori shumë të ndjeshme si dhe ju jeni thirr që mbi bazat e taksave të qytetarëve janë ndarë ato shtëpi për një kategori të caktuar, ndërsa propozimin që bëri kolegu z.Haki Rudari sot nuk paraqet kurrfarë problemi sepse kolegu e sqaroi se edhe më parë ka qenë një komision i tillë dhe në atë komision ka qenë i përfshirë një anëtar i DSHMS-së, në kuptimin e sigurimit të bazës ligjore dhe kontratave.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës besoj se debati përfundoj dhe pa humbur kohë më shumë, e vë në votim propozim vendimi për caktimin e anëtarëve të komisioni të banueshmërisë.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## 12. Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023

**Kryesuesi i Komitetit**, e paraqiti këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, unë si Kryesues i Kuvendit e kam përgatit një raport i cili më tepër është raport teknik dhe ku paraqitet puna që është bërë gjatë tërë vitit, andaj urdhëroni ndokush ka ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth këtij raporti.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, sërish pajtoj me konstatimin e juaj zotëri Kryesues ngase në raportin e juaj janë pasqyruar aktivitetet e Kuvendit, por nuk është pasqyruar se çka kemi pas të planifikuar dhe çka kemi dështuar, mirëpo këtu janë pasqyruar vetëm aktivitetet që kanë përfunduar dhe nuk është pasqyrua çka kemi ngecë si Kuvend, e them këtë sepse fundja referencë është plani i punës dhe si rezultat i punë tonë del raporti i punës së Kuvendit, e që vërtetë kemi shumë dallime, vërtetë nuk jam i kënaqur me punën e Kuvendit, këtu nuk kemi ku ta kritikojmë as Ekzekutivin e askënd tjetër por vetëm vetën tonë dhe më së lehti na bie kur flasim për vetën tonë dhe sigurisht çdo njëri të paktën të bëjë punën e tij do t'i ketë dilemat se a është në funksion për të cilin është mandatar nga qytetarët.

Së fundi, ne po e përmbushim një raport të punës vetëm nga ana formale dhe jemi këtu, por prapë para se ta votojmë në mënyrë formale nuk jam për ta arsyetuar askënd sepse secili e ka moralin dhe karakterin e vet por vërtetë duhet të bëjmë diçka ngase nuk jemi mirë me rolin që na e ka përcaktuar ligji të cilit duhet t'i përmbahemi.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim Raporti e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

*Nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të Raportit përkatës sipas kësaj pike të rendit të ditës.*

## 13. Raporti i Komisionit Ad-Hoc për shikimin, analizimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të të dëmtuarve nga breshëri gjatë vitit 2022

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, kemi të bëjmë me një komision i cili e ka sjellë këtë raport, mirëpo ai komision është i thirrur të raportoj në detaje dhe t'i përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, meqë kam qenë pjesë e komisionit e ndiej obligim që t'ju jap disa informata sepse të gjithë e dimë që në seancën e kaluar me kërkesë të kolegut asamblist z.Ekrem Rrahmani është formuar ky komision Ad-Hoc, dhe pastaj z.Ekrem Rrahmani është zgjedhur Kryesues i këtij komisioni.

Materialin me siguri e keni marr me kohë dhe në këtë janë të cekura disa pika të cilat nuk e di ia vlen t'i cek një nga një ngase janë të gjetura nga ky komision i këtij Kuvendi i cili është formuar vetëm për të mbikëqyr procesin për ndarjen e subvencioneve dhe kërkesat e fermerëve, se si ka shkuar.

Të gjeturat e komisionit janë goxha shumë dhe janë të renditura në dosje të aplikantëve të cilat edhe mund t'ua lexoj, dhe atë: në dosjet e aplikantëve mungojnë raportet e vlerësimit të komisionit komunal si dhe procesverbalet e terrenit, në raport të komisionit nuk ka përputhje të sipërfaqes së dëmtuar dhe asaj të deklaruar, nuk ka përputhje së përqindjes së dëmit nga breshëri ndërmjet procesverbalit të terrenit dhe raportit të vlerësimit, te një pjesë e dosjeve mungojnë fotot, dy kërkesa nga i njëjti bujk me data të ndryshme, pastaj kemi hasur në një raport të pa nënshkruar nga të gjitha palët e komisionit, komisioni ka konstatuar se nga 36 fermerë në listë 16 prej tyre janë kompensuar nga Ministria e Bujqësisë, është e rëndësishme të theksohet se në dosjet e fermerëve që na janë refuzuar nga Ministria ka pas njerëz që me një foto kanë aplikuar dy aplikant. Kështu që ne kemi rekomanduar që listën e fermerëve mos me nda por kjo listë të shkoj si listë e përgjithshme si dhe një vërejtje për komisionin vlerësues komunal për shkak se

nga lëshimet teknike të tyre ka ardh si shkak i refuzimit të kërkesave të fermerëve nga ana e Ministrisë. Tani kemi një fazë goxha të ndjeshme sepse tek fermerët secili individualisht mund të vlerësoj që të votoj për ose kundër për pagesë apo kompensim të dëmeve të këtyre fermerëve.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, rreth çështjes së komisionit për verifikimin e gjendjes që janë refuzuar një pjesë e fermerëve dhe propozimit të dalë në këtë Kuvend për ata fermerë që janë refuzuar, këtu ishte një zbritje nga ajo që kanë deklaruar sa janë të dëmtuar dhe atë për rreth 40%, andaj të zbritësh prej një vlere qindpërqind që kanë aplikuar në Ministri dhe të kthehemi në një vlerë 40%, që ta mbulon nga mjetet e veta Kuvendi Komunal e them se është jashtëzakonisht e vështirë.

Tani po mundohem të tregoj në pika të shkurtra edhe pse të gjitha do i them në mbledhjen e Kuvendit, kemi të bëjmë me një komision e që qëllimi kryesor është që neve na bën inkompetent në këtë vendimmarrje, për mendimin tim është kjo se komuna jonë nuk ka pas shpallje publike për kompensimin e dëmeve të shkaktuara për periudhën kohore që u cek, dhe këta fermer të paktën kanë aplikuar në Ministri si autorite dhe tani Ministria nuk ka dal ta incizoj situatën si pjesë e përgjegjësisë së saj me inspektorët e vet, andaj nuk e di në çfarë baze i kanë deleguar kompetencat te një komision komunal i cili pastaj ka bërë vlerësimin ashtu siç e ka bërë, dhe nga ajo që iu referua edhe kolegu z.Bashkim Sylja dhe nga ajo që ne kemi njohuri, ky komision nuk e ka bërë punën ashtu siç duhet dhe tani jemi në një situatë e që e lexova vetëm rekomandimin e komisionit Ad-Hoc ku thotë se kjo listë të trajtohet si tërësi dhe në këtë rast ne jemi të informuar nga komisioni që taksativisht numëron shkeljet, lëshimet dhe keqpërdorimet e individëve të caktuar mbi bazën e së cilës janë refuzuar nga Ministria, dhe të pretendosh që një këshilltar i Kuvendit të Komunes voton për kompensim të një defekti, vërtetë është ndryshuar roli.

Nëse është vërtetuar që ka pasë malverzime, nëse janë vërtetuar shkeljet e procedurave atëherë këtë situatë qysh mund ta trajtojmë njëjtë sikur ata që kanë deshtë të na vënë në lajthitje si komision, ashtu edhe neve, dhe tani na trajtojnë njësoi, dhe atë me vendimin ton e që kjo për mua është e pa kuptimtë.

Për fund i japi vetit të drejtë që në seancën e radhës të Kuvendit gjerësisht të diskutojmë rreth kësaj pike të rendit të ditës ku vërtetë shpallje publike nuk ka pas Komuna, dhe lind pyetja si mund ta kompensosh dikë kur nuk ke pas thirrje publike, pastaj e lexova diku në raport ku ishte shkruar “vesa” në kllapa shkruante lagështia i ka dëmtuar, por ku nuk ka pasë lagështi (siç i themi ne bastra, dhe kur kemi ne dëme në bujqësi themi se ato i na i ka shkaktuar bastra), mirëpo të shkruhet në raport që vesa dhe bryma në atë periudhë kohore, vërtetë ka parregullsi dhe të pretendosh t’i rregullosh dhe t’i mbulosh padrejtësitë me votim në Kuvend, unë nuk jam për një gjë të tillë, nëse ka ndokund situatë që shkelet komisioni për mos punën e vet duhet ta bëjmë dallimin se nuk mund të trajtohet si tërësi. Nëse vërtetë për fajin e komisionit një bujk ka pësuar, duhet të kompensuar atë bujk por nuk mund t’i barazojmë edhe këtë edhe atë, sepse për të përmirësuar diçka ne shtrohet pyetja qysh kam të drejtë të përmirësoj unë diçka të Ministrisë, apo a e kam atë autoritet unë të përmirësoj diçka që është refuzuar nga Ministria, ne mund t’i japim vetës të drejtë por nuk kemi të drejtë.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, problemi kryesor është që këta fermer janë refuzuar për shkak të gabimeve teknike të komisionit, ne të gjithë e dimë sepse të gjithë punojmë dhe e dimë se në çfarë gjendje janë fermerët dhe çfarë dëmsh kanë pasë nga breshëri, kemi një rast ku një fermer i ka pas 45 ari dhe për shkak që komisioni ia ka shkruar 48 ari kërkesa e tij është refuzuar nga Ministria, dhe tani këtu është problemi më i madh, pastaj kemi raste tjera ku janë 0.8 ari kurse komisioni i’a ka shkruar 80 ari, ky ka qenë gabim teknik dhe për këtë arsye unë kam këtë brengën më të madhe dhe këta fermer më dhimbsen më së shumti kush do qofshin ata sepse kanë presuar për sherrin e 4-5 dallavergjive.

Sa i përket komisionit, nuk ka pas të drejtë në asnjë rast dhe këtë e them ngase kemi qenë në terren dhe nuk kemi mundur ta bëjmë selektimin se kush ka mund të bëj dallavere aty dhe ne nuk kemi mundur si proces ta konstatojmë se kush ka pas dëme e kush jo, por ne si komision e kemi marrë procesin në tërësi, mirëpo unë ju garantoj se së paku gjysma e atyre fermerëve e kanë merituar të subvencionohen, kjo po më

dhemb më së shumti sepse tani atyre t'ju bëhet ajo e padrejtë kur ata kompensohen më së paku kur krahasojmë me 4-5 persona të cilët kanë deklaruar dëme më shumë se të gjithë tjerët. Unë e di që njëri ka 6 €, apo tjetri 200€ - 300€ se sa vlera e dëmit nga 100% i ka zbrit në 40%, e ceka se ky është problemi.

Ashtu siç e di unë Ministria e Bujqësisë është marrë vesh të paguaj një pjesë të këtyre dëmeve komunës, nëse ju i merrni këta persona, kurse ajo pjesën tjetër, tash është goxha telashe.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, shumë mirë ishte sqarimi, një pjesë e tyre të shprehem në gjuhë të popullit është gjynah të mos kompensohen por tani a është gjynah të kompensohen atë dallavergjinjë, tani ne kemi të bëjmë me gjynaha gjithqysh ose këndeje ose andej të paktën unë e kuptoj ashtu. Ne në një formë te komisioni nuk mund t'i trajtojmë njëjtë sikur atë që ka dashur të përvetësoj në mënyrë të kundërligjshme me atë që ka pasë vërtetë të drejtë për t'u kompensuar, qysh do të përfundoj kjo nuk e di por unë mendoj se është dashur të ndahet "shapi prej sheqeri".

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, është problem të dalësh tani në terren dhe të verifikosh gjendjen e tyre dhe është problem ta ndash dikë apo ta fusësh dikë në listë.

**z.Naim Çunaku**, pyetje për parafolësin, theksoi, a keni pas qasje në të gjithë dokumentacionin e komisionit dhe a e keni pa memorandumimin mes Komunës dhe komisionit, jo deklaratimet sepse janë diçka tjetër kurse letrat diçka tjetër sepse aty kanë deklaruar 8 por t'i bëjnë 80 ari.....

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, më falni për vonesën, po dua të ndërlihem me çështjen që u diskutua, u përmend që ka fermer që e meritojnë kompensimin dhe të tjerë që nuk e meritojnë kompensimin, ndoshta është më e rrugës të formohet një komision prej nivelit komunal qoftë edhe prej asamblistëve dhe të bëhet një lloj verifikimi i listës edhe pse ajo pjesë e kulturave mund të jetë e dëmtuar dhe besoj se ka mundësi me marrë informatën direkt në terren ngase ka shumë raste që i njohin edhe njerëzit se kush merret me bujqësi dhe çka kultivojnë e kështu me radhë. Ndoshta është më e drejtë të bëhet edhe një verifikim përfundimtar se sa me marrë një vendim direkt ngase ne edhe ashtu me vendim qoftë pozitiv qoftë negativ dikë po e prek, kështu që vendimi të jetë më i kompletuar, mendoj se duhet bërë një verifikim përfundimtar.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, krejt në funksion të gjetjes së një rruge që të mos ndihet askush i dëmtuar, por të mos shpërblehet edhe një dallavergji. I nderuar drejtor i DPUMM, këtë variantin që ju po e propozoni në radhë të parë kisha dashur që kolegu z.Bashki Sylja nga përbërja e komisionit si pjesë dhe që ka mandatin këtu nga përbërja e komisionit të na jap sqarime, mirëpo unë nuk mendoj se duhet formuar një komision tjetër, mund t'ia vazhdojmë mandatin këtij komisioni dhe ta heqim prej rendit të ditës vendimmarrjen e që pastaj këtyre si komision i'u lihet kohë më e gjatë për të dalë me një Raport të të gjeturave, andaj nuk më duket e nevojshme ngritja e një komisioni tjetër kur e kemi komisionin aktual, dhe për këtë të na jap sqarime më kompetent është kolegu z.Bashkim Sylja.

Pra komisioni aktual të vazhdoj punën dhe të vije me rekomandime dhe adresa të qarta se kush duhet të paguhet e kush jo, ku është malverzimi, ku janë kompetencat, ku është marrëveshja, e them këtë sepse ne nuk guxojmë të votojmë për hatrin e askujt sepse kemi integritet, përndryshe kjo i bie sikur ndonjërit po iu dogj shtëpia të thuhet tani ejani se po ia bëjmë një shtëpi sikurse atij që i është djeg shtëpia njëjtë edhe atij që nuk i është djeg shtëpia, dhe po i'a bëjmë dy shtëpi.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, vetëm një fjali desha ta shtoj se verifikimi i kësaj liste është pak problematike, edhe nëse janë zhdukur faktet gjithsesi mund të ketë ndonjë gjurmë diçka që ka mbet prej të kaluarës, tani ajo është pjesë e kompensimit për një hapësirë që ka pasë pemë ose diçka tjetër, besoj që ka mundësi të verifikohet edhe direkt në terren duke dal për të vërtetuar se a ekziston ose jo ajo pjesë që e kanë deklaruar, besoj se gjurmë ka dhe mundësi me u gjet në këtë aspekt.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, këto dëme në bujqësi kanë ndodh në vitin 2022 dhe prej vitit 2022 tani në vitin 2024 nuk mendoj se ka gjurmë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, këtë që po e thotë drejtori i DPUMM gjurmë ka se është e pa mundur mos me pas gjurmë, shembull nga ajo që u tha nga Kryesuesi vërtetë nuk mund t'i gjejmë gjurmët e brymës, lagështisë, vesës ose bastrës, por nëse një trup ka qenë një vjeçar i dardhës, kumbullës ose qershisë dhe në vitin 2022 një trup një vjeçar dihet se çfarë produkti mund të japë, do të thotë gjurmë ka sa të doni, pastaj nëse dikush ka 8 ari dhe hyn në posedim të pronës së tij që ka atje dhe i shkruhet 80 ari, edhe këtu ka vend për përgjegjësi të dikujt. Gjurmë ka por a kemi të drejtë dhe kohë të merremi ne me këtë me vetë faktin që ka ardhë në Kuvend dikush duhet me marrë përgjegjësi sepse këtu është një vlerë 25,000.00€ - 26,000.00€, mirëpo qofshin edhe 600€ Kuvendi nuk guxon të votoj për, nëse ato mjete keqpërdoren dhe thuajse kjo është një situatë e njëjtë me atë të banimit social.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, po ashtu si kriter kryesor është edhe zona e prekur dhe ne mundemi me ditë përafërsisht se cila zonë ka qenë e prekur dhe e dimë nëse shembull është fshati Balloc dhe Letanc atëherë nuk janë përfshirë të gjithë nga dëmet në këtë rast.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, për këtë çështje janë njerëzit kompetent sepse Ministria ka ndarë 40,000.00€ - 50,000.00€, kjo është punë shumë e thellë që mendoj se sa më shumë futemi në të aty do të ngecim, kurse sa i përket komisionit ne jemi Komision prej Kuvendit për shikimin, analizimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për të dëmtuarit nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2022. Ne dokumentacionin e kemi shikuar dhe për atë që po pretendojmë se disa aplikant janë dallavergjinjë ata i kanë fotot më të mira dhe është goxha specifike kjo punë, e them këtë sepse unë e kam shikuar secilën kërkesë dhe secili anëtar i komisionit e ka shikuar atë dokumentacion dhe pse ai dokumentacion është refuzuar nga Ministria, gjysma e tyre janë refuzuar për shkak të komisionit që ka bërë gabime teknike, se nuk kanë bërë vlerësimin mbi 21%, por kanë vlerësuar 20%, e që vlerën nën 20% Ministria nuk e vlerëson / kompenson por e hedh poshtë. Pra faji është i komisionit, por e cekta se për 3-4 dallavergjinjë po paralizohen 20 të tjerë, kështu që mendoj se është punë me përgjegjësi, përndryshe ju e keni Raportin dhe mund ta lexoni secili dhe të shihni të gjeturat e secilit, mirëpo ka fermer që ka pas 45 ari por ia kanë shkruar 48 ari dhe kjo nuk është në rregull sepse ai fermer është i dëmtuar, kurse Komuna për një mbrëmje të fund vitit paguan 30,000.00€ ndërsa tani 23,000.00€ të mos i'u jepen fermerëve edhe kjo është goxha e rëndë, pastaj janë edhe disa gjëra tjera për të cilat tani spo ju marrë kohë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, më bëri përshtypje një fjali e kolegut z.Bashkim Sylja kur e potencoj shpenzimin e cekur, pra e pyes ku i ka shpenzuar Komuna 30,000.00€ për një darkë të fund vitit, dhe nëse kjo shumë është e vërtetë është shumë. Edhe një herë po mundohem ta sqaroj çështjen në fjalë, nëse është bërë një defekt, atij nuk duhet t'ia shtojmë edhe një tjetër, diçka që nuk mund të kapërcehet dhe shtrohet pyetja kush e ka themeluar atë komision a e ka themeluar Kuvendi, jo, tani çfarë përgjegjësie kemi ne si Kuvend mbi atë komision, cili autoritet jemi ne në raport me atë komision, përndryshe komisioni tjetër i ngritur nga Kuvendit nuk ka krijuar efekte, tani cili është pozicioni i Kuvendit në raport me atë komision të ngritur nga Ekzekutivi, ata janë shërbyes civil dhe nuk ka të bëjë asgjë Kuvendi me ta.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, ai komision nuk i raporton dhe nuk ka të bëjë asgjë me Kuvendin sepse është i ngritur me vendim të kryetarit të Komunës.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, ne si komision i ngritur nga Kuvendi kemi përgatit një rekomandim që ka të bëjë me gabimet e tyre (komisionit të Ekzekutivit), mirëpo ai rekomandim është për Kryetarin dhe sipas informatave që kam, Kryetari i Komunës e ka shkarkuar atë komision për shkak të këtyre vërejtjeve.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, ne mund të debatojmë gjatë por jemi në një situatë ku komision tjetër të ri nuk mund të formojmë sepse komision mbi komision Kuvendi nuk mund të formoj, pra komisioni është i formuar dhe nëse ne nuk jemi të kënaqur me Raportin e tyre mund t'i i japim kohë edhe një muaj që të na e sjellë një Raport më të detajuar, prandaj lidhur me këtë pikë të rendit të ditës konsideroj se debati përfundoj dhe e vë në votim Raportin e Komisionit Ad-Hoc përkatës, që t'i rekomandohet Kuvendit.

*Nga 7 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të Raportit përkatës sipas kësaj pike të rendit të ditës.*

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:00**

**Procesverbalin e mbajtën;**

**Osman Bajrami**

**Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-016/01-0014435/24**

**Podujevë,**

**29 shkurt 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit**

**Hilmi Hoxha**